

**PROJEKTLIGJ**  
Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

MBI HYRJEN E TRANSMETIMIT NUMERIK EKSPERIMENTAL NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83.1 të Kushtetutës, me propozim të \_\_\_\_\_,

**Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**

**VENDOSI:**

**Neni 1**  
**Objekti dhe qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë një kornizë rregulluese për hyrjen e transmetimit numerik në Republikën e Shqipërisë. Brenda kornizës së përcaktuar nga ky ligj, operatorët dhe operatorët e multiplekseve do të lejohen të fillojnë të transmetojnë shërbime transmetimi numerike të një natyre eksperimentale.
2. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit të Shqipërisë (KKRT) do të japë licenca të përkohshme për funksionimin e rrjeteve numerike tokësore të transmetimit. Për këtë qëllim, KKRT-ja do të ofrojë dy frekuenca për funksionimin e dy rrjeteve me frekuencë të vetme. Këto licenca do t'u japin mundësi operatorëve të multiplekseve të krijojnë platforma numerike tokësore dhe të fillojnë e zhvillojnë shërbimet e transmetimit numerik tokësor në Shqipëri. Funksionet e operatorit të multipleksit/platformës përfshijnë vënien në funksionim dhe administrimin e platformës numerike të transmetimit, përfshirë grumbullimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes, mbajtjen e një Sistemi Aksesit të Kufizuar (Conditional Access System) dhe ofrimin e teknologjisë për Shërbime Interaktive (Interactive Services).
3. Dhënia e frekuencave për shërbime të transmetimit numerik mund të kërkojë përdorimin e frekuencave që janë aktualisht të zëna nga operatorët analogë. KKRT-ja mund të vendosë t'u japë këto frekuenca operatorëve të multiplekseve. Në këtë rast, KKRT-ja i jep operatorit analog një frekuencë të re, e cila do ta lejojë operatorin analog që të mbulojë me sinjal të njëjtën zonë. Operatori i multiplekseve që përfiton nga shkëmbimi i frekuencave paguan kostot që dalin për operatorin analog nga ky veprim.
4. KKRT-ja jep licenca të përkohshme për operatorët e platformave numerike satelitore të transmetimit.
5. KKRT-ja përcakton frekuencat, fuqinë, vendndodhjen dhe zonën për të cilat jepen licencat.

**Neni 2**  
**Procedura e licencimit**

1. Mbajtësi i një licence për transmetime analoge tokësore për territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili dëshiron të transmetojë programet e tij në format numerik, duhet të marrë një licencë të përkohshme për transmetim numerik nga KKRT-ja. Kjo licencë mund të jepet pa kaluar nëpër procedurat e konkurrimit të parashikuara me Ligjin nr. 8410, por KKRT-ja ruan të drejtën për të ndryshuar frekuencën, bazuar në nevojat e planit të frekuencave.
2. Aplikuesit për licencë për multipleks, të cilët nuk kanë licencë të vlefshme për transmetime analoge, duhet të marrin pjesë në procesin e konkurrimit, detajet e të cilit përcaktohen nga KKRT-ja. Në vlerësimin e aplikimeve të marra, rëndësi të veçantë duhet të kenë kriteret e mëposhtme:
  - Cilësia e zgjidhjeve teknike, përfshirë shkallën e fleksibilitetit që zgjidhjet e caktuara u ofrojnë përdoruesve në lidhje me zgjedhjen e shërbimeve. Në këtë kuadër, rëndësi duhet t'u kushtohet, mes të tjerave, zgjedhjes së standardeve jopronësore, aty ku është teknikisht e mundshme, dhe zgjidhjeve për Application Program Interface (API) dhe sisteme aksesit të kontrollit.
  - Planet për investim dhe zhvillim të rrjetit, përfshirë shitjen dhe disponueshmërinë e dekoderëve, ritmin e zhvillimit dhe koston për publikun e gjerë.
  - Shërbimet që dëshiron të ofrojë aplikuesi. Rëndësi duhet t'i kushtohet ofertave të ndryshme e të larmishme televizive, që kanë se çfarë t'u ofrojnë grupeve të ndryshme të shikuesve. Kjo vlen si për përmbajtjen e programeve të llojeve të ndryshme, ashtu edhe për marrëdhënien midis kanaleve televizive falas dhe atyre me pagesë.
  - Aftësia dhe kompetenca e aplikuesit lidhur me përmbushjen e planeve të tij, veçanërisht, realizimin komercial të planeve të tilla.
3. Mbajtësi i një licence të multipleksit, i cili dëshiron ta përdorë platformën e tij numerike për veprimtarinë e tij transmetuese, duhet të marrë një licencë tjetër për transmetime numerike tokësore nga KKRT-ja për çdo program në veçanti.
4. KKRT-ja u jep licenca për transmetim programesh atyre aplikuesve të cilët dëshirojnë t'i transmetojnë programet e tyre përmes platformës së multipleksit ose satelitore, sipas një marrëveshjeje me operatorët e multiplekseve dhe satelitorë. Këto licenca mund të jepen pa kaluar procedurat e konkurrimit të parashikuara me Ligjin nr. 8410.
5. Operatorët e platformave numerike satelitore duhet të pajisen me licencë nga KKRT-ja. Këto licenca mund të jepen pa kaluar procedurat e konkurrimit të parashikuara në Ligjin nr. 8410.

### **Neni 3**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e të licencuarve të multiplekseve**

1. Mbajtësit e licencave të multiplekseve dhe të licencuarit për platforma satelitore duhet të financojnë dhe ndërtojnë platformat numerike dhe rrjetet e transmetimit për shpërndarjen e transmetimeve numerike dhe shërbimeve të reja numerike. Nëse ata nuk i përmbushin këto detyrime në afatin kohor që duhet të përcaktohet nga KKRT-ja, KKRT-ja ka të drejtë t'u heqë atyre licencën.
2. Mbajtësit e licencave të multiplekseve dhe të licencuarit për platforma satelitore janë të detyruar t'i ofrojnë Radiotelevizionit Shqiptar, TVSH, kapacitetin e nevojshëm për shpërndarjen e transmetimeve aktuale analoge me cilësi korresponduese dhe pa kosto

shtesë. Të licencuarit janë, po ashtu, të detyruar t'u ofrojnë operatorëve të tjerë shqiptarë, përkundëjt pagesës, kapacitete në rrjetet e tyre, me kushte të arsyeshme, të drejta dhe jodiskriminuese.

3. Mbajtësit e licencave të multiplekseve dhe të licencuarit për platforma satelitore janë të detyruar të sigurojnë që 50% e shërbimeve të tyre transmetuese numerike do t'u ofrohen përdoruesve pa pagesë. Nga programet falas, deri në 30% mund të transmetohen në formë të koduar.
4. Mbajtësit e licencave të multiplekseve dhe të licencuarit për platforma satelitore janë të detyruar të ofrojnë 50% të shërbimeve të tyre të transmetimit në shqip, qoftë duke transmetuar emisione shqiptare, qoftë duke ofruar titra/dublim për programet në gjuhë të huaj.
5. Frekuencat që u jepen operatorëve të multiplekseve duhet të përdoren, kryesisht, për transmetim. Gjithsesi, ato mund të përdoren për lloje të tjera shërbimesh. KKRT-ja duhet të sigurojë që të gjitha shërbimet që u ofrohen operatorëve nga operatorët e multiplekseve bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese. Për sistemet e aksesit të kushtëzuar, Application Program Interfaces dhe guidave programore elektronike, KKRT-ja do të zbatojë parimet e përcaktuara në Direktivën e Bashkimit Evropian të 7 marsit 2002 (Access Directive).
6. Nëse gjatë vlerësimit të aplikimeve të marra, KKRT-ja arrin në përfundimin se vetëm një aplikues i përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 2.2, KKRT-ja mund të vendosë t'ia japë të dyja multiplekset një të licencuari. Në këtë rast, i licencuari për këto dy multiplekse duhet t'u ofrojë operatorëve shqiptarë 50% të kapaciteteve të tij, në bazë të kushteve të arsyeshme, të drejta dhe jodiskriminuese, në përputhje me parimet e përcaktuara nga institucionet e BE-së në fushën e konkurrencës efektive.
7. Operatorët e multiplekseve, operatorët e platformave satelitore dhe operatorët numerikë duhet t'i japin KKRT-së të gjithë informacionin e duhur, në mënyrë që t'i japin mundësi KKRT-së të vlerësojë aspektet teknike dhe komerciale të transmetimeve të tyre provë. Në bazë të këtij informacioni, KKRT-ja harton një raport për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
8. Operatorët e multiplekseve dhe ofruesit e shërbimeve numerike të transmetimit kanë të drejtë të ofrojnë programe me përmbajtje të mirëfilltë seksuale, me kusht që marrja e programeve të tilla kufizohet vetëm te të rriturit përmes mjeteve teknike. Ndalimi i përcaktuar në nenin 38.4 të Ligjit nr. 8410 për transmetimin e programeve pornografike nuk vlen për këto shërbime.
9. Gjatë periudhës eksperimentale, transmetimi i njëkohshëm i shërbimeve të transmetimit në formë analoge dhe numerike, kërkon më shumë se një licencë për programet e televizioneve dhe radiove kombëtare dhe, mundësisht, edhe për ato lokale. Dispozitat e nenit 20 në Ligjin nr. 8410 që ndalojnë mbajtjen e më shumë se një licence radiotelevizive kombëtare dhe lokale nuk do të zbatohen gjatë periudhës eksperimentale te transmetimit numerik tokesor.

#### **Neni 4 Tarifat**

.....

...

## **Neni 5**

### **Standardizimi dhe ndërfunksionimi i shërbimeve numerike interaktive të transmetimit**

KKRT-ja nxit operatorët e multiplekseve dhe operatorët e platformave satelitore për të vënë në funksionim një Application Program Interface, në përputhje me standardet ose specifikimet e miratuara nga një organizatë e standardeve evropiane dhe për t'u ofruar klientëve dekoderë të përshtatshëm.

KKRT-ja mundet që, në fund të periudhës eksperimentale, të vendosë standarde dhe specifikime të tilla në frymën e situatës në treg për shërbimet numerike që mbizotëron në atë moment, duke marrë parasysh nevojat e konsumatorëve dhe qëllimin për të promovuar një mjedis të qëndrueshëm për ofrimin e shërbimeve të tilla në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 6**

### **Kohëzgjatja e licencës**

Licencat e operatorëve të multiplekseve, operatorëve të platformave satelitore dhe licencat e operatorëve numerikë do të kenë të njëjtën kohëzgjatje. Këto licenca do të jepen për një periudhë fillestare prej 3 vjetësh, me kushtin që KKRT-ja të ketë të drejtë të ndryshojë kushtet e licencës për të reflektuar detyrimet ndërkombëtare dhe kërkesat që burojnë nga administrimi i spektrit. Në fund të kësaj periudhe, KKRT-ja informon Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në Raportin e saj Vjetor, për përvojën e përfituar gjatë kësaj periudhe provë, së bashku me një strategji numerike dhe propozime për një legjislacion të detajuar dhe gjithëpërfshirës për kalimin nga transmetimi analog në atë numerik. Nëse Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nuk e miraton ligjin para skadimit të licencës, KKRT-ja mund ta zgjasë afatin e licencave për periudha kohore prej një viti, derisa ky ligj i përkohshëm të zëvendësohet nga një ligj i përhershëm. Operatorët e multiplekseve dhe operatorët numerikë me licencë të vlefshme në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri duhet të jenë të favorizuar në tenderin publik për licenca të reja transmetimi multipleks dhe numerik ndaj atyre që konkurrojnë për herë të parë, në rast se u janë përmbajtur dispozitave të këtij ligji dhe kanë përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara nga tenderi publik.

## **Neni 7**

### **Korniza e përgjithshme ligjore për veprimtaritë transmetuese**

Me përjashtim të atyre dispozitave specifike të përjashtuara përmes këtij ligji, Ligji nr. 8410 për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë vazhdon të rregullojë të gjitha veprimtaritë transmetuese në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 8**

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.